

LIGJ
Nr. 47/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 15/2019, “PËR NXITJEN E PUNËSIMIT”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen këto shtesa:

1. Shkronja “ç” e pikës 4 riformulohet si më poshtë:
“ç) familjarët e individëve me aftësi të kufizuar”.
2. Në shkronjën “h” të pikës 4 pas fjalëve “të rinjtë me moshë nën 29 vjeç” shtohen fjalët “që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional”.
3. Pas pikës 20 shtohet pika 21 me këtë përmbajtje:
“21. Kuponi për financimin e formimit profesional” është kupon që u jepet punëkërkuesve të papunë, të cilët ndjekin një kurs formimi profesional në subjektet private të formimit profesional.”.

Neni 2

Në nenin 11 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:
 - a) Shkronja “g” riformulohet si më poshtë:
“g) programe sipas skemës së garancisë rinore;”.
 - b) Shkronja “k” riformulohet si më poshtë:
“k) këshillimin për punësim për grupet e veçanta;”.
 - c) Pas shkronjës “k” shtohet shkronja “l” me këtë përmbajtje:
“l) skemën e kuponit për financimin e formimit profesional.”.
2. Në pikën 4 fjala “vendim” zëvendësohet me “vendime”.

Neni 3

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 11/1

Skema e garancisë rinore

1. Skema e garancisë rinore është pjesë e programeve të punësimit që mbështet të rinjtë, sipas nenit 3, pika 4, shkronja “h”, të këtij ligji.
2. Në kuadrin e skemës së garancisë rinore, të rinjve, sipas nenit 3, pika 4, shkronja “h”, të këtij ligji, u ofrohet një ofertë punësimi/arsimimi të vazhdueshëm/praktika profesionale brenda një periudhe prej katër muajsh nga momenti i regjistrimit në zyrën përkatëse të punësimit.
3. Ministria përgjegjëse për politikën e punësimit dhe formimit profesional është përgjegjëse për hartimin e planit të zbatimit të skemës së garancisë rinore dhe koordinon zhvillimin e kuadrit ligjor të nevojshëm për zbatimin e tij.

4. Programet, sipas skemës së garancisë rinore, dhe procedurat e zbatimit përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.”.

Neni 4

Në pikën 2 të nenit 14 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Në shkronjën “d” hiqen fjalët “nxitjes së”.

2. Pas shkronjës “dh” shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:

“e) “shërben si sekretariat teknik i Fondit Social të Punësimit, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi”.

Neni 5

Pika 2 e nenit 20 ndryshohet si më poshtë:

“2. Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave, sipas pikës 1 të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit në masën 100 për qind të pages minimale në shkallë vendi për çdo muaj për çdo person që i përket grupeve të përcaktuara në nenin 3, pika 4, shkronja “c”, të këtij ligji, që ai duhet të kishte punësuar sipas këtij neni. Kontributi derdhet nga punëdhënësi dhe pasqyrohet në listëpagesën mujore të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të deklaruar në sistemin on-line të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, institucion i cili luan rolin e agentit tatimor për mbledhjen e kontributit. Procedurat dhe mënyra e derdhjes së kontributit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.”.

Neni 6

Në pikën 3 të nenit 21 në fund të fjalisë së dytë shtohen fjalët “me përjashtim të të ardhurave nga buxheti i shtetit.”.

Neni 7

Pika 3 e nenit 24 ndryshohet si më poshtë:

“3. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat që brenda datës 31.12.2023 të miratojë aktin nënligjor për procedurat dhe mënyrën e mbledhjes së kontributit për Fondin Social të Punësimit në zbatim të nenit 20, pika 2, të këtij ligji.”.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 22.6.2023.

Shpallur me dekretin nr.115, datë 11.7.2023 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj